

<p>Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren Prof. Asoc. Dr. Mentor Alishani, Rektor</p> <p>Rruga e Shkronjave, nr. 1 20000 Prizren, Republika e Kosovës Email: rektorati@uni-prizren.com</p>	<p>Institut de Coopération et Développement Institut pour le Développement et l'Éducation Tahir SHABANI - President</p> <p>3, rue de Vallard 74240 Gaillard Tel: +33 7 60 99 56 78 E-mail: alfa74@live.fr http://institut-icd.org France</p>
---	--

Memorandum për bashkëpunim ndërmjet : Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim në France dhe Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren

Lidhur më: 04/01/2024 ndërmjet:

I - Palët nënshkruese

* Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren, i përfaqësuar, nga Prof. Asoc. Dr. Mentor Alishani, Rektor, tani e tutje si UUHP.

dhe

* Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim (në gjuhën Frënge "Institut de Coopération et Développement"), i përfaqësuar nga, z. Tahir Shabani, President, tani e tutje si IBZH.

Preambula

UUHP dhe IBZH (në vijim të referuara si "Palët"), shprehin dëshirën për të bashkëpunuar në promovimin e bashkëpunimit akademik, arsimor dhe kulturor mes dy institucioneve në kushtet e përcaktuara. Tash e tutje, ato kanë lidhur Memorandumin aktual të bashkëpunimit.

Ky Memorandum do të zhvillohet në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe do të lehtësojë zhvillimin e mëtejshëm dhe shqyrtimin e formave të bashkëpunimeve të veçanta me interes të ndërsjellë për të dyja palët.

II - Objekti i Memorandumit

Bashkëpunimi do të zbatohet përmes, por nuk mund të jetë i kufizuar në veprimtaritë e mëposhtme:

* Krijimin e mundësive për rrjetëzim dhe shkëmbim reciprok të mësimdhënësve, personelit të kërkimit, studentëve dhe stafit tjetër për ligjërata, vizita dhe shkëmbim të përvojave me universitetet e ndryshme Frankofone nga Franca dhe Zvicra – Evropë;

mëtejshme. Amandamentimet dhe ndryshimet mund të bëhen vetëm në rast të miratimit me shkrim nga përfaqësuesit e të dyja palëve dhe do t'i shtohen këtij Memorandumi. Ky Memorandum mund të ndërpritet para skadimit të periudhës pesë (5) vjeçare, vetëm me pëlqimin me shkrim të përfaqësuesve të të dyja palëve.

Secila palë që dëshiron të bëjë ndryshime ose të ndërpresë Memorandumin, e njofton institucionin tjetër me shkrim për qëllimin e tillë, jo më vonë se gjashtë (6) muaj para ndryshimeve të sugjeruara ose ndërprerjen që duhet të hyjë në fuqi.

Memorandumi nuk mund të ndërpritet, nëse ky veprim do të rrezikojë zbatimin e ndonjë prej aktiviteteve të dakorduara, ose para afatit të përcaktuar për përfundimin e aktiviteteve të tilla.

V - Hyrja në fuqi e Memorandumit:

Ky Memorandum i Bashkëpunimit përbëhet nga (4) katër kopje të njëjta, nga dy (2) kopje për secilin nënshkrues dhe do hyjë në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij, më 04 Janar 2024. Në dëshmi të kësaj, palët e mësipërme vënë nënshkrimet e tyre dhe protokolohet.

Në dëshmi të kësaj, palët e sipërpërmendura vënë nënshkrimet e tyre:


Nënshkrimi dhe vula


Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
Prof. Asoc. Dr. Mentor Alishani, Rektor
20000 Prizren, Republika e Kosovës


Nënshkrimi dhe vula


Institut de Coopération et Développement
8, rue de Vallard - 74240 Gaillard France
Tél: +33 7 60 99 56 78 alfa74@live.fr
Institut për Bashkëpunim dhe Zhvillim
President, Z. Tahir SHABANI
Ambasador dhe Lider për Paqen Botërore

* Pjesëmarrjen e përbashkët dhe aplikimin për fonde të caktuara për arsim, kërkim dhe aktivitete të tjera artistike dhe kulturore;

* Aktivitete të përbashkëta arsimore, trajnuese ose kërkimore;

* Organizimin e përbashkët të konferencave, simpoziumeve, kongreseve, seminareve, kurseve, shkollave verore, dhe formave të tjera të bashkëpunimit me interes të përbashkët;

* Shkëmbimin e informacionit në fushat me interes për të dyja palët;

* Aktivitete të tjera me interes të përbashkët akademik;

* Të dyja palët tentojnë që nëpërmjet këtij bashkëpunimi të bëjnë promovimin e vlerave kulturore, organizimin e panaiereve pranë institucioneve ndërkombëtare, si dhe krijimin e raporteve përmes urave të miqësisë me shfrytëzimin e diplomacisë publike, kulturore dhe ekonomike në Evropë.

Bashkëpunim për projekte me interes të përbashkët kërkimor studiues në përputhje me deklaratën e Bolonjës dhe standardet evropiane për arsim të lartë në Kosovë.

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, Fakulteti i Edukimit, Fakulteti Juridik, Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Filologjisë.

Marrëdhënieve ndërkombëtare • Integritet Evropian • Diplomacisë ekonomike

Konferenca të përbashkëta shkencore, simpoziumet dhe tryezat e rumbullakëta ndërkombëtare

Shkolla ndërkombëtare verore - prioritet universitetet Frankofone në Evropë

Në zbatimin e bashkëpunimeve të veçanta, një marrëveshje e shkruar që mbulon të gjitha aspektet relevante, duke përfshirë financimin dhe detyrimet e tjera që do të ndërmerren nga secila palë dhe do të negociohen për çdo rast, duke rënë dakord reciprokisht dhe formalizuar me shkrim, para fillimit të këtij bashkëpunimi.

III - Zbatimi i Memorandumit:

Secili institucion do të caktojë një person kontaktues për të koordinuar zbatimin e këtij Memorandumi. Palët janë zotuar të mos kryejnë veprimtaritë e lidhura me këtë Memorandum, pa konsultime paraprake.

Palët bien dakord që të gjitha marrëveshjet financiare të nevojshme për zbatimin e këtij Memorandumi të negociohen dhe të varen nga disponueshmëria e fondeve. Asnjëri institucion nuk do të ketë ndonjë detyrim financiar ndaj institucioneve të tjera në bazë të këtij Memorandumi.

IV - Kohëzgjatja e Memorandumit:

Ky Memorandum do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga përfaqësuesit e institucioneve dhe do të jetë në fuqi për pesë (5) vite, me mundësi të zgjatjes nga palët për një periudhë të